



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 570/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi, kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** i pabazuar apeli Anr.570/2021, i parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike Ashkalive të Kosovës (PDAK), me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave nga diaspora.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.03.2021 në ora 15:30, nga subjekti politik Partia Demokratike Ashkalive të Kosovës (PDAK), duke pretenduar se sipas informatave që posedojnë nga Diaspora dhe kontaktimi i votuesve nga Diaspora, si dhe dëshmitë e votave nga Diaspora, nuk korrespondojnë me rezultatin nga QNR. Më tutje theksojnë se kanë rreth 800 vota nga diaspora kurse ne rezultate kanë dalur 142 vota.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i, që të rinumrohen votat e Diasporës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumërohen të gjitha votat nga diaspora ndërsa në raport me këto pretendime në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se mbi cilat shkaqe e kërkon një gjë të tillë, pasi rinumërimi i votave të ardhura nga diaspora duhet të mbështete në dëshmi të qarta për manipulim qoftë me rastin e dorëzimit, apo me rastin e numërimit, e të cilat shkaqe parashtruesi i apelit ka dështuar që ti argumenton, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Paneli, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për t'i vërtetuar dyshimet e tij të pretenduara në apel edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e apelit, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat eventualisht nuk ka qenë në gjendje ti ketë në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Pretendimet e përgjithshme e të pa mbështetura në ansjë provë relevante si të tilla mbesin pretendime paushallë, mbi bazën e të cilave PZAP nuk mund të vendos ndryshe, përveç asaj që është vendosur në dispozitivi të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.570/2021 më datën 05.03.2021

**Kryesuesi i Panelit**  
**Faton Adem**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.